



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

**Autoriteti për Infomimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)
Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe
Rikuperimit të Personave të Zhdukur**

Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) shpall shpall konkurimin e hapur në procedurën e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për vendin vakant në pozicionin:

- Drejtor, Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur;
- Kategoria e pagës II-1;

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) mund aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE	18.4.2024
Afati për dorëzimin e dokumentave për: NGRITJE NË DETYRË	23.4.2024

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Drejtori i Drejtorisë ka këto detyra:

1. Përcakton objektivat, planifikon, koordinon, drejton veprimtarinë e drejtorisë për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave që u zhdukuën apo u ekzekutuan gjatë komunizmit, në funksion të qartësimit të fatit të të vdekurve apo të zhdukurve gjatë kësaj periudhe;
2. Në bazë të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti, informon institucionet qendrore dhe vendore për marrjen e masave nga ana e tyre për mbrojtjen dhe ruajtjen e vendeve që janë aktualisht si vendvarrime apo do të identifikohen si të tilla;
3. Përgjigjet për ndjekjen, organizimin mbajtjen e marrëdhënieve ndërinstitucionale me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore dhe organizatave të ndryshme, ndërmarrjen, finalizimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe të lidhura për qëllimet e përcaktuara në Nenin 22/1 të ligjit 45/2015, i ndryshuar, në funksion të bashkëpunimit për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur dhe të të ekzekutuarve, si dhe për masat për ruajtjen e vendvarrimeve;
4. Mbi bazën e kërkesave të subjekteve kërkuese dhe rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin tonë organik dhe aktet nenligjore të zbatimit të tij, i paraqet Autoritetit për legjitimim kërkesën dhe merr masat për zhvillim të procedurës deri në kthimin e përgjigjes kërkuarit;
5. Organizon punën për hulumtimin e dokumenteve arkivore të Autoritetit dhe të arkivave të tjera të organeve ligjzbatuese, të cilat nuk janë eksploruar deri më sot për çështjen e të zhdukurve dhe të ekzekutuarve me dhe pa gjyq gjatë regjimit komunist;
6. Në bazë të urdhrave dhe objektivave koordinon punën me specialistët e Drejtorisë, në funksion të zgjidhjes së problematikave të krijuara, për realizimin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve gjatë periudhës komuniste;
7. Organizon dhe ndjek projekte institucionale dhe ndërinstitucionale, me përfshirjen e grupeve të interesit në çështjen e të zhdukurve dhe drejtësinë tranzicionale në vend, identifikon mjete dhe metoda binjakëzimi;
8. Raporton për dokumentet arkivore të Autoritetit dhe të arkivave të tjera të organeve ligjzbatuese, të cilat nuk janë eksploruar deri më sot për çështjen e të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve gjatë periudhës komuniste;
9. Organizon informacionet e mbledhura në këtë fushë nga institucione të tjera, si dhe mbi bazën e kërkesave dhe dëshmiave të dhëna nga të afërmit e familjarëve të personit të zhdukur apo të ekzekutuar dhe i bën ato pjesë të databazës së madhe për të zhdukurit në diktaturë;
10. Raporton në mënyrë periodike të Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme e Trajtimit të Kërkesave mbi aktivitetin e Drejtorisë, problematikën, mënyrën e zgjidhjes, përmirësimet e nevojshme dhe ja paraqet sipas rastit Autoritetit;
11. Në përputhje dhe në përshtatje me aktivitetin e Autoritetit, mban të gjitha përgjegjësitë dhe kryen të gjitha detyrat e tjera të ngarkuara;
12. Në zbatim dhe përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregulloren e brendshme të Autoritetit, ndjek zbatimin nga ana e specialistëve të procedurave dhe rregullave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale apo ato që mund të klasifikohen si sekret shtetëror;

13. Ndjek projektet institucionale dhe ndërinstitucionale, me përfshirjen e grupeve të interesit në procese konsultuese;
14. Kryen detyra të tjera sipas kërkesave të eprorëve, brenda fushës së veprimtarisë së drejtorisë

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në fushën juridike, të albanologjisë, arkeologjisë, antropologjisë, mjekësisë ligjore, shkencat e natyrës. Të zotërojnë diplomë universitare “Master Shkencor” në të njëjtën fushë (*Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion, nga të cilat jo më pak se 1 vit në nivel të mesëm drejtues
- c) Do të kenë prioritet kandidatët me përvojë të dokumentuar në organet e rendit publik ose kërkimit shkencor
- d) Do të kenë prioritet kandidatët që janë të pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP).
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur, në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (jo më të vjetër se 1 muaj);
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë gjithashtu kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 18.4.2024, në adresën: Zyra e Arkiv-Protokollit, "Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", Njësia Administrative nr .4, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej” Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Jo më vonë se data **20.4.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit për shkaqet e moskualifikimit, (nëpërmjet adresës të e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Njohuritë mbi legjislacionin:

- a) Njohuri mbi Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”, i ndryshuar;

- b) Njohuri mbi *“Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*;
- c) Njohuri mbi ligjin nr.9802, datë 13.09.2007 *“Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB”Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, personave të zhdukur me forcë”*;
- d) Njohuri mbi Rezolutën e Parlamentit Europian, *“Mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin” (2009)*,
- e) Njohuri mbi Deklaratën e Pragës *“Mbi ndërgjegjen europiane dhe komunizmin” (2008)*,
- f) Njohuri mbi Rezolutën 1096 (1996) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës *“Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”*,
- g) Njohuri mbi Rezolutën 1481 (2006) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës *“Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”*,
- h) Njohuri mbi Rezolutën më të fundit të Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019), të njohura nga Kuvendi i Shqipërisë;
- i) Njohuri mbi Ligjin Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- j) Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, *“Për rregullat e etikës në administratën publike”*;
- k) Njohuri mbi Ligjin Nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*;
- l) Njohuri mbi Ligjin Nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”*, i ndryshuar;
- m) Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar; Njohuri mbi Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*;
- n) Njohuri mbi Udhërefyeshin për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit (faqe web e Autoritetit);
- o) Njohuri mbi librin, *“Protokolli i Bournemouth-it për mbrojtjen dhe hetimin e varreve massive”* (i botuar nga ICMP);
- p) Njohuri mbi Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003, *“Për Arkivat”*;
- q) Njohuri mbi Ligjin Nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”*;
- r) Njohuri mbi Ligjin Nr. 10/2023 *“Për Informacionin e Klasifikuar”*;
- s) Njohuri mbi VKM Nr. 662, date 17.11.2017, *“Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave”*;
- t) Njohuri mbi VKM Nr.190, datë 4.3.2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 81, datë 28.01.2008, të Këshillit të Ministrave, "për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"”*;
- u) Ligji nr.7514, datë 30.9.1991 *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish te denuarve dhe te perndjekurve politike”*, i ndryshuar;
- v) Njohuri mbi ligjin nr.9831, date 12. 11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”* i ndryshuar;
- w) Nohuri mbi *“Kodin e Procedurës Penale”* dhe *“Kodin Civil”*

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e institucionit dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lire.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar i një kategorie më të ulët;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në fushën juridike, të albanologjisë, arkeologjisë, antropologjisë, mjekësisë ligjore, shkencat e natyrës. Të zotërojnë diplomë universitare “Master Shkencor” në të njëjtën fushë (*Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion, nga të cilat jo me pak se 3 vite në nivel të ulët drejtues
- c) Do të kenë prioritet kandidatët me përvojë të dokumentuar në organet e rendit publik ose kërkimit shkencor
- d) Do të kenë prioritet kandidatët që janë të pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP).
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (jo më të vjetër se 1 muaj);
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë gjithashtu kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 23.4.2024, në adresën: Zyra e Arkiv-Protokollit, "Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", Njësia Administrative nr.4, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej” Tiranë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Jo më vonë se data **7.5.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*” dhe në faqen zyrtare listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Njohuritë mbi legjislacionin:

- a) Njohuri mbi Ligjin Nr. 45/2015 “*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH*”, i ndryshuar;
- b) Njohuri mbi “*Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit*”;
- c) Njohuri mbi ligjin nr.9802, datë 13.09.2007 “*Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, personave të zhdukur me forcë*”;
- d) Njohuri mbi Rezolutën e Parlamentit Europian, “*Mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin*” (2009),

- e) Njohuri mbi Deklaratën e Pragës “Mbi ndërgjegjen europiane dhe komunizmin” (2008),
- f) Njohuri mbi Rezolutën 1096 (1996) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Masat për të çrrënjosur trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”,
- g) Njohuri mbi Rezolutën 1481 (2006) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”,
- h) Njohuri mbi Rezolutën më të fundit të Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019), të njohura nga Kuvendi i Shqipërisë;
- i) Njohuri mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- j) Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- k) Njohuri mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- l) Njohuri mbi Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar;
- m) Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; Njohuri mbi Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- n) Njohuri mbi Udhërefyeshin për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit (faqe web e Autoritetit);
- o) Njohuri mbi librin, “Protokolli i Bournemouth-it për mbrojtjen dhe hetimin e varreve massive” (i botuar nga ICMP);
- p) Njohuri mbi Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat”;
- q) Njohuri mbi Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
- r) Njohuri mbi Ligjin Nr. 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar”;
- s) Njohuri mbi VKM Nr. 662, date 17.11.2017, “Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave”;
- t) Njohuri mbi VKM Nr.190, datë 4.3.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 81, datë 28.01.2008, të Këshillit të Ministrave, "për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"”;
- u) Ligji nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të perndjekurve politike”, i ndryshuar;
- v) Njohuri mbi ligjin nr.9831, date 12. 11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” i ndryshuar;
- w) Nohuri mbi “Kodin e Procedurës Penale” dhe “Kodin Civil”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*, të Departamentit të Administratës Publike

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në portalin *“Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”* dhe faqen zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.